



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONI RREGULLATOR**

Data: 17.1.2025

Nr: 2

Ora: 13:00

VENDIM

PËR

**DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 05, DATË 20.11.2020, "PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E
KOMISIONIT TË ZONËS SË ADMINISTRIMIT ZGJEDHOR", I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 20, pikat 1, shkronja "a", e 3, nenit 46, pikat 1 dhe 2, nenit 50, pika 3, neneve 52, 62, 93, 108, pika 7 dhe nenit 109, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator,

VENDOSI:

I. Në tekstin e vendimit nr. 05, datë 20.11.2020, "Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e KZAZ-së", i ndryshuar, të Komisionit Rregullator, bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë vijon:

1. Në nenin 6, në fund të pikës 2, shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

"...Në çdo rast lista paraqitet dhe/ose në platformën elektronike të dedikuar nga personi përgjegjës i autorizuar nga KQZ me kredencialet përkatëse në këtë sistem."

2. Në nenin 6, në pikën 5, pas shkronjës b), shtohen shkronjat c) dhe ç), me këtë përmbajtje:

c) Vetëdeklarimin e kandidatit se plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 31 të Kodit zgjedhor dhe se nuk është në kushtet e papajtueshmërisë sipas përcaktimeve të nenit 30 të Kodit Zgjedhor.

ç) Për kandidatët që janë nëpunës të administratës publike dorëzohet leja e dhënë nga punëdhënësi për t'u angazhuar si anëtar i administratës zgjedhore apo një dokument i njëvlershëm.

3. Në nenin 11, shkronja "ë" ndryshohet si më poshtë vijon:

"ë) Në rast se anëtari/ sekretari i KZAZ-së ose subjektet zgjedhore evidentojnë ose dyshojnë se një anëtar ose sekretar i KZAZ-së është në një nga kushtet e papajtueshmërisë të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni duhet të informojë menjëherë Komisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve me një raport të argumentuar, të shoqëruar me faktet dhe dokumentacionin që provon ekzistencën e kushteve të parashikuara në këtë pikë."

Data: 17.1.2025 Nr: 2
Ora: 13:00



Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 05, datë 20.11.2020, "Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor", i ndryshuar

4. Në nenin 11, shtohet pika 2 me këtë përmbajtje:
2. “Administrata e KQZ-së heton administrativisht pretendimet e palëve dhe shqyrton dokumentacionin e paraqitur duke përfshirë konsultimin apo komunikimet në rrugë elektronike me palët dhe përgatit një raport të detajuar me gjetjet dhe rekomandimet e tij.”
5. Në nenin 12, shtohet pika 5, me këtë përmbajtje:
5. “Anëtari/ sekretari merr në dorëzim detyrën duke plotësuar një procesverbal në të cilin përmbledhen dokumentet e administruara, plotësuara dhe të gjitha materialet e dorëzuara me anëtarin/ sekretarin që largohet. Një kopje e procesverbalit i dorëzohet menjëherë KQZ-së dhe një kopje administrohet nga Sekretari i KZAZ-së.”
6. Në nenin 16, në pikën 3, pas fjalës “telefonike”, hiqet togfjalëshi “të rrjetit fiks”.
7. Në nenin 26, pikat 3 dhe 4, ndryshojnë si më poshtë vijon:
- “3. Anëtari dhe sekretari i KZAZ-së, brenda 5 (pesë) ditëve pas publikimit të listës së kandidatëve për deputet / organeve drejtuese të njësisive të vetëqeverisjes vendore, duhet të vetëdeklarojë nëse është ose jo në marrëdhënie krushqie, gjinie apo marrëdhënie pune me ndonjë prej kandidatëve sipas përcaktimeve të nenit 32, pika 2 të Kodit Zgjedhor. Në çdo rast, nëse anëtari i KZAZ-së emërohet pas kësaj periudhe, duhet të dorëzoj në KQZ edhe formularin e vetëdeklarimit të konfliktit të interesit sipas modelit të miratuar nga Komisioneri.
4. Sekretari i KZAZ-së dërgon në KQZ jo më vonë se 2 (dy) ditë pas afatit të përcaktuar në pikën 3 të këtij neni, vetëdeklarimet e anëtarëve/ sekretarit të KZAZ-së. Në rastet kur anëtari ka deklaruar se është në kushtet e konfliktit të interesit, KQZ-ja i kërkon subjektit politik propozues të sjellë një propozim tjetër për zëvendësimin e anëtarit në fjalë brenda 3 (tre) ditëve.
8. Neni 33, riformulohet si më poshtë vijon:
- “1. Ngarkohet administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për zbatimin e këtij vendimi.
2. Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve”.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- III. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

Ilirjana NANO

Kryetar

Arens ÇELA

Anëtar

Dritan ÇAKA

Anëtar

Helga VUKAJ

Anëtar

Muharrem ÇAKAJ

Anëtar